



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0404

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së OE " ARMAKOS " SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës” me numër të prokurimit 616-23-1625-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 03.08.2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e " ARMAKOS " SH.P.K. me nr. 2023/0404, e datës 16/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës”, me numër të prokurimit 616-23-1625-1-2-1, iniciuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK) – Kurse vendimi i AK, Vërtetohet

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës” me numër të prokurimit 616-23-1625-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 €.

Me datë 19.05.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpallur fitues operatorin ekonomik ankues “Armkos” Sh.P.K. Me datë 24.05.2023 operatori ekonomik "Professional Alarm" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 29.05.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka miratuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ashtu që aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Pas procedurës së rivlerësimit, me datë 02.06.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpallur fitues operatorin ekonomik ankues “Professional Alarm” Sh.P.K. Me datë 02.06.2023 operatori ekonomik ankues “Armkos” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 07.06.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 28.04.2023, operatori ekonomik ankues me datë 16.06.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 404/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:
“Ne kemi dorezuar tenderin/oferten tone me date 20/05/2023 (Ligji percakton vetem daten e fundit per dorezim te ofertave po nuk ndalon dergimin e ofertave para kesaj date) ku i kemi bashkangjitur edhe sigurimin e tenderit ne vlere 1000 eur siq eshte kerkuar ne Fleten e te Dhenave te Tenderit (FDT), prej 90 ditesh. konform nenit 57 te LPPK... Perkunder se ka pasur shtyerje afati per dorezimin e tenderve, garancioni i jone per sigurimin e tenderve i mbeshtetur ne FDT ne afat prej 90 dite ka pasur gjatesi te mjeftueshme kohore per te mbuluar gjithe procesin siq e percakton afatin kohor neni 57 i LPPK... Kur AK na ka shpallur fitues dhe ka kerkuar origjinalin e Garancionit te Sigurimit te tenderit te cilin ne e kemi derguar, ne nuk kemi pasur ndonje vrejteje per afat pasi eshte logjike se garancioni i sigurimit te tenderit ka vlefshmeri efektive vetem deri sa te nenshkruhet kontrata gjate te cilit proces kerkohet, pas te cilit kerkohet garancioni i sigurimit te ekzekutimit te tenderit nese eshte kerkuar... Konform sqarimeve te me sipërme ne konsiderojme se eliminimi jone eshte i pa drejte, jo ligjor dhe mbeshtetur ne interpretime te gabuara”.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 56, 57, dhe 72 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20.06.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 29.06.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon: *“eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “ ARMAKOS ” SH.P.K., të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues”*.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ankues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka dorëzuar te Paneli Shqyrtues njoftimin sipas të cilit Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit me arsyetimin si në vijim: *“vendimi i ekspertit është i pabazuar dhe i mbështetur në interpretime jo pragmatike të nenit 57 të LPP dhe RRPP. Ne kemi dhënë arsyetimin tonë dhe qëndrojmë të palëkundur se shkaqet e eliminimit tonë nga komisioni vlerësues nuk qëndrojnë...”*.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin. - *Administrimi dhe vlerësimi i provave* -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se *“eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertën e tij ka dorëzuar sigurimin e ofertës për 90 ditë mirëpo ky sigurim është lëshuar/nxjerrë me datë 27.03.2023. Duke ju referuar ofertës së OE ankues vërehet se ky sigurim është lëshuar me datën 27.03.2023 dhe po nga kjo datë fillon vlefshmëria e sigurimit për 90 ditë që është i vlefshëm deri me datën 25.06.2023 që do të thotë se sigurimi i ofertës nuk e mbulon as validitetin e ofertës konform nenit 28.6 të RRPP përderisa ofertat janë hapur me datën 27.04.2023. Sipas nenit 28.6 të RRPP - Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Sipas pikës 4 validiteti i ofertës është*

kërkuar për 60 ditë nga data finale për dorëzimin e tenderëve prej datës 27.04.2023 deri me datën 25.06.2023 ndërsa validiteti i sigurimit të ofertës është 90 ditë. Nga datat e mësipërme vërehet se sigurimi i ofertës nuk është në harmoni me dosjen e tenderit siç është kërkuar prej 90 ditë nga dorëzimi i tenderit dhe nuk është në harmoni me nenin 28.6 të RRPP. Nga sqarimet e mësipërme oferta e OE ankues është e papërgjegjshme. Rrjedhimisht pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar”.

Paneli Shqyrtues ka gjetur se nuk është fare kontestues fakti në dosjen e tenderit është kërkuar “sigurimi i tenderit për 90 ditë nga hapja e tenderëve”. Po ashtu nuk është kontestues fakti që hapja e tenderëve është bërë me datë 27.04.2023. Këto dy fakte nuk janë kontestuese pasi që evidentohen si të tilla në ankesën e operatorit ekonomik ankues por edhe në vendimin e datës 29.05.2023 të autoritetit kontraktues mbi kërkesën për rishqyrtim. Për më tepër këto fakte jokontestuese mund të konfirmohen edhe përmes dosjes së tenderit respektivisht përmes procesverbalit të hapjes së tenderëve. Konkretisht sipas dosjes së tenderit (tutje “DT”) nr. i nenit 13.2 është përcaktuar se shuma e sigurimit të tenderit është 1,000.00 Euro për 90 ditë. Në anën tjetër përmes formularit B54 Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të dt. 13.04.2023 është bërë njoftimi se hapja e ofertave do të bëhet me datë 27.04.2023 në ora 13:30. Ky fakt mund të konfirmohet edhe përmes procesverbalit të hapjes së tenderëve të datës 27.04.2023. Pra nuk është aspak kontestuese që kriteri i DT ka qenë sigurimi i tenderit me vlefshmëri prej 90 ditëve konkretisht duke filluar nga data e hapjes së tenderëve me 27.04.2023 deri me datë 25.07.2023.

Duke marrë parasysh faktet jokontestuese si më sipër, nga oferta e operatorit ekonomik ankues është gjetur se i njëjti ka dorëzuar edhe sigurinë e tenderit sipas nr. të policës 060010150089211 në shumën 1,000.00 Euro me vlefshmëri nga data 27.03.2023 deri me 25.06.2023. Polica e sigurimit është lëshuar nga K.S. “SIGKOS” Sh.a. me datë 27.03.2023. Kjo nënkupton që vlefshmëria e sigurimit të tenderit në rastin konkret përfundon para datës 25.07.2023 dhe rrjedhimisht nuk është në përputhje me kriterin e DT.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ankues me ç’rast ka gjetur se pretendimet ankimore janë tërësisht të paqëndrueshme. Argumentimi i ekspertit shqyrtues jo vetëm që është i detajuar dhe i kuptueshëm por është edhe i bazuar në dëshmitë dhe dokumentet që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konkretisht konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen edhe përmes raportit të komisionit vlerësues por edhe përmes dosjes së tenderit dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit, njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, kërkesës për rishqyrtim si dhe vendimit të Autoritetit kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim. Për më tepër konstatimi dhe argumentimi i ekspertit shqyrtues është i mbështetur në LPP dhe legjislacionin sekondar për prokurimin publik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues. Duke marrë parasysh se të gjeturat e njëjta janë evidentuar edhe në vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 29.05.2023 ndaj kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, Paneli Shqyrtues ka gjetur se edhe ky vendim ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet ankimore. Rrjedhimisht Paneli

Shqyrtues i ka falur besimin edhe vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 29.05.2023 ndaj kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues janë të pabazuara në tërësi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatorit ekonomik ankues.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatorit ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 19.05.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës” me numër të prokurimit 616-23-1625-1-2-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorit ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " ARMAKOS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: